



International Observation Mission to Kosovo Municipal Elections 2009	
Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit në Kosovë për Zgjedhjet komunale 2009	Međunarodna posmatračka misija - Lokalni izbori na Kosovu 2009

## ***Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Preliminare***

### **Zgjedhjet e para në Republikën e Kosovës janë mbajtur në një atmosferë të qetë të shënuara me disa shkelje të procedurave**

**Prishtinë, 16 nëntor, 2009**

Rrjeti Evropian për Organizatat për Monitorimin e Zgjedhjeve është një grup i 18 organizatave udhëheqëse qytetare nga 17 vendet e Evropës lindore dhe qendrore dhe Azia qendrore. Organizatat anëtare të ENEMO kanë monitoruar më tepër se 140 zgjedhje kombëtare dhe kanë trajnuar më tepër se 190,000 vëzhgues. Qëllimi i ENEMO është të përkrah interesin e komunitetit ndërkombëtar në promovimin e dekomkracisë në regjionin në të cilën angazhohet, të vlerësoj , proceset zgjedhore dhe mjedisin politik, dhe të ofroj raporte vëzhguese të sakta dhe të paanshme. Misionet ndërkombëtare vëzhguese të ENEMO vlerësojnë procesin zgjedhor duke përdorur standardet ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike dhe standardet në legjislacionin dhe kushtetutën e vendit të vlerësuar.

Pas marrjes së ftesës nga Kryetari i Republikës së Kosovës Dr. Fatmir Sejdiu për të vëzhguar Zgjedhjet Komunale 2009, me 12 tetor, 2009, Ekipi Kryesor i ENEMO ka arritur dhe është përgatitur të dërgoj 12 vëzhgues afatgjatë në 6 ekipe duke mbuluar tërë territorin e Kosovës për monitorimin e mjedisit para zgjedhor përfshirë fushatën parazgjedhor dhe aktivitetet e administrimit zgjedhor para 15 nëntorit. Në ditën e zgjedhjes, ENEMO ka dërguar 106 vëzhgues të zgjedhjeve në 563 vend votime, në të gjitha komunat e Kosovës ku zgjedhjet janë mbajtur.

Për këtë Mision Vëzhgues Zgjedhor vëzhguesit e ENEMO vijnë nga 16 organizata anëtare të ENEMO dhe 8 vende të ndryshme nga Evropa dhe Eurasia.

Raporti preliminar vëzhgues i ENEMO është i bazuar në vrojtimitet e gjetjeve të vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtë lidhur me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të zgjedhjeve. Misioni thekson se raporti preliminar nuk paraqet një vlerësim përfundimtar të tërë procesit zgjedhor. ENEMO nuk do të dorëzoj vlerësimin përfundimtar deri në fund të procesit zgjedhor që përfshinë numrimin e votave, shpalljen e rezultateve, balotazhet e mundshme dhe ankesat e mundshme që do të adresohen.

## Përfundimet preliminare

- Komisioni Qendror Zgjedhor është përpjekur të krijoj kushtet e nevojshme për një mbarëvajtje efikase dhe pozitive të procesit zgjedhor. Kjo punë është bërë në mënyrë transparente për tejkalimin e pengesave dhe sfidave me të cilat janë përballur në zgjedhjet e para pas pavarësisë.
- Zgjedhjet Komunale dhe për Kryetar të Komunës 2009 në Republikën e Kosovës kanë përmbushur shumë nga standardet ndërkombëtare për zgjedhje, sidoqoftë, një situatë e ndërlikuar politike ka shpër në paaftësinë e një pjese të elektoratit të ushtror të drejtën e tyre për votim në disa zona.
- Fushata është bërë në mënyrë paqësore dhe dinamike e prishur vetëm nga disa raste të izoluara të sjelljeve të këqija gjatë javës së kaluar. Pretendimet e pa dëshmuara të mashtrimeve sistematike kanë ndikuar edhe më tepër në atmosferën e procesit zgjedhor.
- Përkundër përpjekjeve nga KQZ-ja të përmirësoj listën e votuesve, mospërputhjet në Regjistrin Civil mbesin një pengesë për një list cilësore, kështu duke lënë hapësirë për spekulime të manipulimit në Ditën e Zgjedhjeve.
- Fillimi i vonshëm i një institucioni të rëndësishëm për procesin zgjedhor, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, KZAP, ka lënë mundësinë për një besim të zvogëluar në procesin zgjedhor.
- Përdorimi i përgjithësuar i votimit me kusht i shtohet sfidave dhe shpenzimeve të procesit zgjedhor. Ato shtohen edhe më tepër nga votimet jashtë vendit, një koncept i pazakonshëm për zgjedhjet Komunale dhe për Kryetar të Komunave.

---

## Historiku

Në vitin 1998 Kosova shpërtheu në një konflikt të dhunshëm. Duke iu frikësuar kthimit të luftërave brutale ballkanike të viteve të 90-ta, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) intervenoi në vitin 1999. Serbët larguan pas kthimit të shqiptarëve të Kosovës dhe gjetën strehim në Serbi dhe Kosovë veriore. NATO siguroi kordonet rreth komuniteteve etnike për parandalimin e dhunës dhe konfliktit të mëtejshëm.

Një marrëveshje paqësore, e ndërmjetësuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, u nënshkrua nën kushtet e paraqitura në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, duke i dhënë Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) autoritet administrativ të Kosovës. Institucionet e Përkohshme të Vetë Qeverisjes (IPVQ) u themeluar nën autoritetin e UNMIK-ut, duke iu dhënë vetë-qeverisje të kufizuar të kosovarve. UNMIK administroi Kosovës deri në shpalljen e paravërsisë në vitin 2008. Edhe pse teknikisht i autorizuar sipas rezolutës 1244, UNMIK-u më nuk ushtron ndonjë autoritet të vërtetë.

Në vitin 2005, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së Kofi Annan caktoi të Dërguarin Special për të gjetur një zgjidhje për statusin e cunuar të Kosovës. Ish kryetari i Finlandës Martti Ahtisaari kaloi disa muaj në takimet e vitit 2006 me përfaqësuesit e Serbisë dhe Kosovës për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse për propozimin e statusit. Në këtë raport, Ahtisaari propozoi kushtet për pavarësi që përfshinin, të drejtat gjuhësore, kulturore, shoqërore, politike për komunitetet pakicë, me theks të veçantë për serbët e Kosovës. Disa përpjekje për ndërmjetësimin e marrëveshjes në mes të Beogradit dhe Prishtinës dështuan, dhe në vitin 2008 Prishtina shpalli pavarësinë, duke u zotuar që të zbatoj pakon e

Ahtisaarit. Ky zotim është kushtëzuar nga shtetet sovrane si një kusht për njohjen e Republikës së Kosovës.

Kosova ka një traditë të ngritur për mbajtjen e zgjedhjeve që nga viti 2000. Dy zgjedhje Komunale (2000 dhe 2002) dhe dy zgjedhje Parlamentare (2001 dhe 2004) u mbajtën para vitit 2007. Të gjitha këto zgjedhje janë administruar dhe organizuar nga komuniteti ndërkombëtar.

Zgjedhjet Lokale, për Kryetar Komune, dhe të Përgjithshme janë mbajtur me 17 nëntor 2007 dhe janë organizuar dhe menaxhuar nga komunitetit ndërkombëtar.

Zgjedhjet aktuale Lokale dhe për Kryetar Komune 2009 janë të parat që janë organizuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

---

## Korniza Ligjore

Që nga shpallja e pavarësisë me 17 shkurt, 2008, Kosova ka adoptuar Kushtetutën dhe disa ligje që qeverisin mbajtjen e zgjedhjeve.

Kushtetuta i përmbahet rekomandive dhe obligimeve të paraparaa në Propozimin Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Kosovë<sup>1</sup>, që thekson të drejtat dhe liritë e komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.

Edhe pse Kosova nuk është nënshkruar i asnjë traktati për të drejtat e njeriut, sipas nenit 22 të Kushtetutës ajo obligohet ti jep prioritet para ligjeve të Kosovës disave nga traktatet kryesore siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe për standardet zgjedhore Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike.

Ligjet kryesore mbi zgjedhjet janë Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të cilat janë miratuar në qershor 2008.

Aktet e tjera të rëndësishme ligjore për zgjedhjet lokale të 2009 janë Ligji mbi Vetë-Qeverisjen Lokale dhe Ligji mbi Kufijtë Administrativ Komunal.

Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme lë vend që shumë aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor të përshkruhen dhe vendosen nga Komisioni Qendror Zgjedhor (CEC) përmes të miratimit të Rregullave Zgjedhore. Për zgjedhjet lokale të vitit 2009 KQZ-ja ka lëshuar katërmbëdhjetë Rregulla të ndryshme Zgjedhore.

Kushtetuta, ligjet kryesore mbi zgjedhjet, dhe Rregullat e KQZ-së përshkruajnë aspektet e ndryshme të një procesi zgjedhor duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore për zgjedhje demokratike sipas standardeve ndërkombëtare. Mirëpo, janë disa çështje në legjislacionin dhe rregullat ekzistuese që duhet të adresohen.

Neni 95 i Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme i jep votuesit një mundësi të votoj me kusht nëse nuk gjinden në listën e votuesve. Votimi me kusht është një zgjidhje që shpesh përdoret në mjediset pas konflikteve për t'iu dhënë votuesve mundësinë të votojnë edhe pse ai/ajo nuk është në listën e votuesve ku ai/ajo pretendon se ka të drejtë të votoj.

Votimi me kusht ka shumë mangësi dhe pa nevojë vonon shpalljen e rezultateve të numërimit dhe paraqet një rrezik potencial për uljen e besimit në tërë procesin. Gjithashtu ka shpenzime shtesë pasi që

---

<sup>1</sup> [www.unosek.org](http://www.unosek.org)

kontrollet e rrepta të votimit dhe numërimit duhet të bëhen; sigurimi, transportimi, dhe qendra zgjedhore si shembull.

Nevoja për vazhdimin e votimit të përgjithësuar dhe standardizuar me kusht, duhet të diskutohet. Për shembull, procedurat e ngjashme me nevojat e veçanta për votim mund të zbatohen për rastet e mbetura specifike siç janë Personat e Zhvendosur.

Sikurse parashihet në Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme KQZ-ja ka për detyrë të menaxhoj shumicën e aspekteve të regjistrimit të partive politike dhe zbulimit financiar si dhe regjistrimin e entitetit politik dhe kandidatit. Shumica e rregullave zgjedhore të elaboruara nga KQZ-ja kanë të bëjnë me entitetet dhe kandidatë politik. Për zbatimin e procedurave afatgjate, stabile dhe transparente, ligjet të veçanta lidhur me regjistrimin dhe operimin e partive, entiteve, dhe kandidatëve politik duhet të merren parasysh.

Gjatë javëve të kaluara para zgjedhjes dokumentet identifikuese të votuesve ka qenë temë e gjerë e diskutimit publik. Ligji parasheh në mes tjerave edhe pasaportin valid dhe letërnjoftimin valid duke mos specifikuar origjinën e dokumenteve. Shqetësimet janë ngritur veçanërisht nga komunitetet pakicë rreth përdorimit të identifikimit valid nga jashtë Kosova. Në kontekstin e Kosovës është posaçërisht e rëndësishme që votuesit, shumë para Ditës së Zgjedhjeve, të kenë informata të qarta dhe të kuptueshme lidhur me dokumentin identifikues të pranueshëm dhe valid.

Votimi jashtë vendit për zgjedhjet lokale nuk është një praktikë e rëndomtë. Për shkak të shumë sfidave teknike dhe logjistike kjo procedurë ka shpenzuar energjinë e administrimit zgjedhor. Praktikrat më të mirë demonstronë se zgjedhjet Lokale fokusohen në adresimin e çështjeve lokale dhe janë në interes të qytetarëve që jetojnë në vend.

## **Administrimi zgjedhor**

Zgjedhjet lokale komunale dhe për Kryetar komune 2009 janë zgjedhjet e para për të cilat Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) është tërësisht përgjegjës për përgatitjen e mbajtjen e zgjedhjeve. KQZ-ja përkrahet nga Sekretariati (SKQZ) dhe 36 Komisioni Komunale Zgjedhore (KKZ) që zbatojnë vendimet e KQZ-së dhe janë përgjegjëse për rregullimet administrative dhe logjistike të nevojshme për zgjedhje. KQZ-ja përbëhet nga 11 anëtarë me një ulëse të emëruar nga Kryetari i Kosovës për gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

Në përgjithësi, KQZ-ja ka treguar një nivel të lartë të angazhimit gjatë përgatitjes së zgjedhjeve. Rekrutimi dhe trajnimi i stafit administrues dhe vendvotues në zonat jo serbe si dhe prokurimi i materialit në përgjithësi janë bërë në mënyrë të duhur. Shpërndarja e materialit të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm zgjedhor nëpër komunë është realizuar shumë mirë.

Sidoqoftë, ka qenë e dukshme se KQZ-ja ende varet nga ndihma e jashtme. Disa aktivitete të rëndësishme janë organizuar nga IFES siç janë Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve, vendosja e vend votimeve mobile në tri komunat veriore serbe të Kosovës dhe fushtatat për informimin e votuesve. Gjithashtu, OSBE-ja ka qenë shumë e dukshme duke dhënë këshilla teknike në nivel qendror dhe lokal.

Gjatë tërë periudhës zgjedhore KQZ-ja ka bashkëpunuar me grupe të ndryshme të interesit për ngritjen e rolit të tyre si administrues të zgjedhjeve dhe kanë mbajtur kanale të vazhdueshme dhe të hapura të komunikimit. Mirëpo, dukshmëria e ulët e fushatës për edukimin e votuesve, e udhëhequr nga KQZ-ja, mbetet një fakt.

Një shqetësim tjetër është se votuesit (veçanërisht në zonat me popullatë pakicë), nuk janë informuar me kohë dhe në mënyrë të duhur për vendet që do të votojnë, ose për rregullimet alternative që janë bërë. Vend votimet alternative nuk janë siguruar e që ka shpjer në mungesën e kohës për informimin e votuesve në mënyrë të duhur për ndryshimet e lokacioneve të vend votimeve.

Në ditën e zgjedhjeve KQZ-ja ka mbajtur një varg të konferencave për shtyp për të informuar opinionin për rrjedhën e zgjedhjeve.

Caktimi i anëtarëve të KKZ, stafi i vend votimeve dhe përzgjedhja e vend votimeve në komunitetet serbe të Kosovës ka hasur në shumë vështirësi. Stafi që ishte caktuar më herët kishin dhënë dorëheqje dhe ndërtesat publike nuk mund të përdorshin si vend votime. Në komunat veriore të Zveçanit dhe Zubin Potokut vetëm një vend votim mobil ishte hapur. Për shkaqe sigurie asnjë vend votim nuk është hapur në komunën e Leposaviçit.

## **LISTA E VOTUESVE**

Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për zgjedhjet e 2009 ka qenë 1.563.741. Edhe pse KQZ-ja kë bërë një punë të madhe për pastrimin e listave të votuesve ky problem ende është i dukshëm. Procedurat ligjore shumë të ndërlikuara dhe të gjatë për shtimin ose fshirjen e të dhënave në listat e votuesve mbetet një sfidë.

Lista e votuesve në Kosovë shumë është debatuar dhe kritikuar për përmbajtjen e shumë emrave që i takojnë të vdekurve ose personave që për ndonjë arsye janë futur gabimisht. Nuk ekziston një regjistrim aktiv i votuesve, ndërsa lista e votuesve është një fragment i regjistrimit civil të Kosovës që është pjesë e strukturës së administratës civile në secilën komunë.

The total number of registered voters for the 2009 elections was 1.563.741. Although the CEC has done a considerable job of cleaning the voters lists' it still remains a problem. The highly complex and long legal procedures for addition or deletion of data in the voters lists' remains a challenge.

The voters list in Kosovo has been much debated and criticized for containing many names belonging to deceased or persons that for some reason have been erroneously included. There is no active voter registration, rather the voters list is an extract of the Kosovo civil registry which is part of the civil administration structure in each municipality.

## **Fushata**

Periudha para zgjedhore është shënuar me fushatë dinamike dhe aktive të kandidatëve dhe partive politike; nga tubimet e mëdha në zonat urbane deri te tubimet më pak formale dhe diskutimeve me njerëz në rrugë, restorante, dhe vende ku qytetarët mbledhen.

Periudha zyrtare e fushatës filloi me 15 tetor. Mjedis i fushatës kryesisht ka qenë i qetë, përkundër disa incidenteve të dhunshme. Udhëheqësit e mëdhenj politik kanë udhëtuar në masë të madhe, duke mbajtur tubime në tërë vendin. Zyret e fushatave lokale ishin hapur në shumicën e regjionieve. Fushata rrallë është njollosur me gjuhë të vrazhdë kundër rivalëve. Kah fundi i fushatës, kandidatës organizonin takime të mëdha me koncerte, që tërhiqnin popullatën e re. Një aspekt negativ është se shumë të mitur kanë qenë aktivisht të përfshirë në fushatat e kandidatëve dhe partive, si aktivistë ose përkrahës të disa mendimeve politike. Është vërejtur se fushata ka qenë më e dukshme dhe më e shtrenjtë në kryeqytet dhe në televizionin kombëtar, shumë më tepër se në nivel lokal dhe në aktivitetet derë më derë.

Shumë grupe të ndryshme të interesit kanë shfaqur shqetësim për respektimin e kufizimeve shpenzuese gjatë fushatës. Është e rëndësishme që KQZ-ja të vëzhgoj këtë çështje për së afërmi, veçanërisht raporteve për dokumentim financiar të Fushatës.

Ka pasur raste të ndryshme të thyerjes së dritareve të shtabeve partiake, shpërthimit të gomave (Gjilan) etj.

Autokolona e Kryeministrit Thaçi është sulmuar me gurë dhe ve në mbërmje të mërkurës, 11 nëntor, me rastin e largimit nga qyteti perëndimor i Deçanit pas një tubimi të organizuar nga Partia e tij Demokratike e Kosovës, ose PDK. Përveç këtij shembulli, ka pasur edhe disa ngjarje të dhunshme motivet e të cilave nuk janë krejtësisht të qarta. Pritet që institucionet e duhur të veprojnë në mënyrë efikase për adresimin e këtyre rasteve.

Bazuar në fushatat shumë aktive dhe të dukshme përfundimi është se votuesit kishin zgjedhje si në përmbajtje ashtu edhe në informacion, dhe se kandidatët kanë shpallur programe të detajuara me shpresën e fitimit të zgjedhjeve.

## Media

Rrjeti Evropian për Organizatat për Monitorimin e Zgjedhjeve – misioni ENEMO nuk ka kryer një monitorim të plotë të mediave. Prandaj, të gjitha komentet në këtë pjesë janë të bazuara në vërtetimet e thjeshta dhe intervistave me akterët medial.

Spektori i mediave në Kosovë është zhvilluar shpejt pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999 dhe sot njerëzit kanë një zgjedhje të gjerë të televizionit, radios dhe gazetave, Mirëpo, shumë gazeta, edhe pse me ndikim në mesin e elitave urbane, kanë një numër dukshëm të vogël të qarkullimit ndërsa televizioni është bërë burimi kryesor i informimit për opinionin publik.

Kushtetuta parasheh një media të lirë dhe pluraliste por në muajt e fundit një numër i raporteve negative për situatën e mediave janë publikuar nga disa akterë të pavarur. Në një komunikatë shtypi në qersho 2009<sup>2</sup>, Freedom House ka kërkuar nga Qeveria ti adresoj dhe hetoj në mënyrë të plotë kërcënimet e bëra ndaj gazetares hulumtuese Jeta Xharra. Në raportin e tij mbi situatën në Kosovë të datës 14 tetor<sup>3</sup>, në kapitullin kushtuar Lirisë së të Shprehurit, Bashkimi Evropian ka deklaruar se “pavarësia dhe paanshmëria e RTK-së, që është pronë publike, nuk janë siguruar në tërësi”. Me 16 tetor, Reporterët pa Kufinj<sup>4</sup> kanë gjetur se “liria e mediave në Kosovë ka degjeneruar mjaft”. Rangimi i Kosovës për lirinë e mediave ka rënë në vendin e 75-të në këtë vit nga vendi i 58-të në vitin. Në fund, me 26 tetor, European Broadcasting Union (EBU) i ka dërguar një letër publike<sup>5</sup> Kryeministrit Thaçi duke shprehur se EBU “është shumë e shqetësuar për presionin politik dhe financiar që qeveria e tij i bën RTK-së dhe stafit të saj para zgjedhjeve të para në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë”.

Një numër i gazetarëve kanë konfirmuar problemet brenda sektorit dhe gjithashtu kanë përmendur presionin financiar në mediat private që nganjëherë shpie në ndikim gjatë raportimit.

Shumica e mediave janë dominuar nga fushata zgjedhore dhe përveç mbulimit të lajmeve të zakonshme dhe një numri të reklamave politike, ka pasur edhe një numër i debateve politike posaçërisht në garën për kryetar të komunës duke iu dhënë secilit kandidat mundësia e barabartë për shpalljen e programeve të tyre politike. Koha për entitetet e ndryshme politike në debate të tilla rregullohet saktë me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe deri më tani nuk është ndërgjuar ndonjë ankesë ndaj përmbushjes së këtyre dispozitave.

Media elektronike monitorohet nga Komisioni i Pavarur për Media, KPM, një organ i themeluar përmes kushtetutës. Në raportin e tij të parë dy-javor<sup>6</sup> mbi mediat në fushatë, Komisioni konkludon se

<sup>2</sup> Freedom House press release 12 June 2009, (<http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=70&release=1007>)

<sup>3</sup> European Commission: Kosovo under UNSCR 1244/99 2009 Progress Report

<sup>4</sup> Reporters without borders: Press Freedom index 2009 (<http://www.rsf.org/en-classement1003-2009.html>)

<sup>5</sup> [http://www.ebu.ch/en/union/news/2009/tcm\\_6-66520.php](http://www.ebu.ch/en/union/news/2009/tcm_6-66520.php)

<sup>6</sup> MONITORING OF MEDIA BROADCASTERS DURING THE COVERAGE OF CAMPAIGN FOR LOCAL ELECTIONS 2009, ([http://www.kpm-ks.org/images/stories/raporti\\_zgjedhjet\\_2009\\_eng.pdf](http://www.kpm-ks.org/images/stories/raporti_zgjedhjet_2009_eng.pdf))

transmetuesit medial kryesisht iu kanë përmbajtur Ligjit mbi Zgjedhjet. Transmetimi i lajmeve është perceptuar si neutral dhe i baraspeshuar edhe partitë e mëdha shqiptare të Kosovës kanë dominuar transmetimin për shkak “të fushatave politike më të ngjeshura”. Problemi kryesor që është vërejtur kanë qenë disa raste të mos-identifikimit të reklamave- që bie ndesh me nenin 49 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme.

Sa i përket mediave të shkruara nuk ekziston ndonjë rregullator shtetëror por në vend të tij një numër i madh i gazetave janë bashkuar për të themeluar Këshillin e Mediave të Shkruara<sup>7</sup>, për të vepruar si një organ vetë-rregullativ për mediat e shkruara. Deri më tani këshilli nuk ka adresuar ndonjë çështje lidhur me fushatën zgjedhore në gazeta.

## **Shoqëria civile**

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor. Motivimi i zgjedhësve, edukimi i zgjedhësve dhe observimi i zgjedhjeve janë segmente në të cilat shoqëria civile duhet aktivisht të merr pjesë. Në atë drejtim, vërehet gjithashtu se aty nuk ka një motivim të dukshëm dhe të strukturuar të fushatës, as nga administrimi i zgjedhjeve e as organizatat e shoqërisë civile të cilat do të ndikonin mbi votuesit për të marrë pjesë më aktivisht në zgjedhje dhe në dalje në vend-votime në një numër më të madh.

Në total ishin 10 organizata të shoqërisë civile të akredituara nga KQZ dhe brenda totalit të 2560 vëzhguesve vendor ishin të akredituar për Zgjedhjet Lokale 2009.

Megjithatë, nuk kishte një fushatë “Dilni të votoni” të dukshme dhe të strukturuar të zhvilluar nga ndonjë prej funksion-bartësve brenda shoqërisë civile.

Grupi më i dukshëm i vëzhguesve vendor të zgjedhjeve që akreditonte në total 2131 vëzhgues ishte ombrella e OJQ-ve vendore “Demokracia në veprim”. Përveç ditës Z “Demokracia në Veprim” përcolli procesin prej fazave të hershme të saj dhe informoi publikun mbi gjetjet e saj në baza javore. Demokracia në veprim mbajti një sërë konferencash për shtyp gjatë rrjedhës së ditës së votimit si dhe në përmblylje të saj.

OJQ “KIPRED” zhvilloi një monitorim të mediave të shkruara dhe atyre emetuese në kuadër të fushatës së tyre. KIPRED informoi publikun mbi gjetjet e tij në një mënyrë frekvente.

Kishte përpjekje të theksuara për të zvogëluar daljen në zgjedhje nga një grup vendor – Vetëvendosja duke l ftuar votuesit të bojkotojnë zgjedhjet.

## **Pjesëmarrja e grave**

Përkundër kornizës ligjore që promovon barazinë gjinore si “një vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë”<sup>8</sup>, pjesëmarrja e grave në institucionet politike dhe shtetërore në Kosovë është shumë e kufizuar.

Ligji mbi Zgjedhjet Lokale fton për “së paku 30% të kandidatëve të certifikuar të gjinisë tjetër” (neni 7.2) në listat e kandidatëve që garojnë për Asambletë Komunale dhe alokimi i ulëseve pas zgjedhjeve duhet të përcjellë të njëjtin 30 % minimum edhe nëse votat në listat e hapura të kandidatëve duhet të prodhojnë rezultat tjetër. Kjo rregullore ishte përcjellur gjatë certifikimit të entiteteve politike. Gjatë fushatës gjithashtu kishte pasur raste të debateve të fokusuara dhe takimeve politike veçanërisht që adresonin gratë në shoqëri.

<sup>7</sup> <http://www.presscouncil-ks.org/>

<sup>8</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7.

Megjithatë, në dritë të këtyre përpjekjeve pjesëmarrja e grave në shumë faza të procesit ishte e ulët. Nga 205 kandidatë që garonin për kryetar komune vetëm 11 janë gra. Mungesa e grave gjithashtu është shumë e evidente te autoritetet zgjedhore. Ndonëse e kryesuar nga një grua, dhjetë anëtarët tjerë të mbetur të Komisionit Qendror Zgjedhor janë meshkuj. Në Komisionet Komunale Zgjedhore vetëm 2 nga 33 zyrtarët ekzekutiv<sup>9</sup> të KKZ janë gra dhe vetëm 9 % të anëtarëve janë gra. Gjithashtu në Komitetet e qendrave të zgjedhjeve gratë janë në një pakicë të qartë. Në 563 qendrat votuese të vizituara nga vëzhguesit e misionit vetëm 14 % ishin femra.

## Komunitetet

Në linjë me shqetësimet e ngritura në planin e Ahtisarit, kushtetuta e Republikës së Kosovës ka një kaptinë të veçantë mbi të drejtat e Komuniteteve dhe anëtarëve të saj. Përkundër dispozitave për Kuvendin e Kosovës, nuk ka dispozita për ulëse të ndara në asamblatë komunale për Komunitetet minoritare.

Megjithatë, ekzistojnë dispozita tjera që synojnë të garantojnë interesat e komuniteteve minoritare. Të gjitha komunat do të kenë Komitetin e Komuniteteve me minimum një përfaqësues nga secili Komunitet minoritar që jeton në komunë. Për më tepër, në komunat me së paku dhjetë përqind (10%) të banorëve që u përkasin Komuniteteve që nuk janë shumicë në këto komuna, do të jetë Nën-Kryetari i Asamblesë Komunale për Komunitete (i mbajtur nga kandidati i komunitetit jo-shumicë i cili mori shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhjet e Asamblesë Komunale), dhe zëvendës bashkiaku për Komunitete I zgjedhur nga asambleja komunale.

Autoritetet elektorale në nivele të ndryshme duhet të reflektojnë Komunitete të ndryshme në Asamblenë e Kosovës dhe nëse duhet Komisionet Komunale Zgjedhore mund të ngrisin numrin e tyre të anëtarëve për ti dhënë qasje përfaqësuesve të Komuniteteve minoritare. Një shembull për këtë është KKZ në Prishtinë ku një anëtar është shtuar për të përfshirë komunitetin Ashkali.

Nga 74 entitete të certifikuar për garë në këto zgjedhje, 40 përfaqësojnë komunitete të ndryshme minoritare në Kosovo, si në vijim:

- Serb të Kosovës 22
- Boshnjak të Kosovës 7
- Turq të Kosovës 4
- Ashkali të Kosovës 2
- Malazez të Kosovës 2
- Egjiptian të Kosovës 1
- Goranë të Kosovës 1
- Romë të Kosovës 1

Komunitete të ndryshme kanë pasur qasje në media të ndryshme duke adresuar shqetësimet e tyre dhe të shumtën në gjuhën e tyre. Shumica nga këto janë stacione lokale TV apo radio dhe në disa raste mediat lokale të printuara, por emetuesi publik RTK gjithashtu ka emetuar rreth 30 % të lajmeve të saj dhe programeve informative në gjuhët minoritare.

Shumica e partive të komuniteteve minoritare kanë shprehur kënaqësinë me procesin zgjedhor ndonëse ato vuajnë nga mungesa e fondeve për ndonjë fushatë të/ elaboruar. Fokusimi kryesor në garë të zgjedhjeve kishte qenë në pjesëmarrjen e Serbëve të Kosovës në procesin elektorale. Siç është vërejtur më parë, 22 entitete të ndryshme të komunitetit Serb të Kosovës të regjistruar për zgjedhje por në të njëjtën kohë thirrjet për bojkotimin ishin të fuqishme nga shumë anë përfshirë edhe Kishën Ortodokse Serbe, Asamblenë e Komunitetit të Komunave të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë, Këshillin Nacional Serb. Nga qeveria në Beograd, komentit zyrtar ishte se “nuk ka pasur kushte që Serbët të

<sup>9</sup> KKZ në 3 komunat veriore në rastin më të mirë ishin emëruar në letër, përderisa puna është kryer nga IFES dhe KKZ Mitrovica.

votojnë” dhe madje se ishte vendim i secilit person, ishte bërë e qartë se përkrahja për institucionet e Kosovës do të nënkupton, mos-përkrahje në të ardhmen nga strukturat të ashtuquajtura paralele Serbe.

## **Dita - Z**

Ne ditën e zgjedhjeve, 106 vëzhgues janë vendosur për të përcjell procedurën e hapjes, votimit dhe numërimit. Vëzhguesit vizituan 563 vendvotime në më shumë se 500 prej 746 qendra të votimit dhe përcjellën numërimin dhe transferimin e rezultateve të të gjitha 36 KKZ-re. Vëzhguesit e ENEMO mbushen deri 700 forma të vëzhgimit.

Procesi i votimit u vlerësua pozitivisht në 93 përqind të vendvotimeve të vizituara dhe në përgjithësi procedurat e votimit janë përcjellur; megjithatë, disa mangësi procedurale janë vërejtur. Në 4 për qind të vendvotimeve të vizituara, anëtarët e komitetit të vendvotimit çdo herë nuk kanë kontrolluar në mënyrë përshtatshme për ngjyrën dhe në 2 për qind të vendvotimeve letërnjoftimet e votuesve nuk janë kontrolluar çdoherë duke rezultuar në mundësi për votim të shumëfishtë apo të përafërt.

Fshehtësia e votës nuk është respektuar gjithëherë. Në veçanti, rastet e votimit në grup apo votimit familjar janë vërejtur në 34 për qind të vendvotimeve, votimi i përafërt në 7 për qind dhe tentimet për të ndikuar në votues afër 4 për qind. Personat e paautorizuar kanë qene prezent në 7 për qind të vendvotimeve të vizituara dhe në 3 për qind të vendvotimeve personat e paautorizuar kanë udhëhequr punën e komisioneve.

Vëzhguesit e ENEMO raportuan disa probleme lidhur me mungesën e udhëzimeve të qarta për atë se cilat letërnjoftime ishin valide dhe në 26 raste vëzhguesit vlerësuan se votuesit janë kthyer mbrapsht për arsye të pajustificuara. Në zonat ku vendvotimet alternative ishte dashur të caktohen, vëzhguesit vlerësuan se në 18 raste votuesit nuk ishin informuar përshtatshëm për lokacionin e ri.

Vëzhguesit apo përfaqësuesit e partive ishin prezent në 92 për qind të vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e ENEMO. Vëzhguesit lokale qene prezent në 87 për qind të vendvotimeve të vizituara, me se shpeshti përfaqësonin Demokracinë në Veprim (82 për qind të të gjitha vendvotimeve).

Në përgjithësi, numërimi u vlerësua pozitivisht në shumicën e vendvotimeve të vizituara. Vëzhguesit e ENEMO vlerësuan se komitetet e vendvotimeve e bënë me të mirën për të përcjellur procedurat dhe për të minimizuar rrezikun e problemeve formale për dorëzimin e materialit të KKZ-te. Rastet e izoluar të mos-përmbajtjes me procedurat janë vërejtur dhe në dy raste procesi ishte vështirë të përcjellët plotësisht në vendvotim i cili ishte i organizuar në mënyrë të papërshtatshme. Prezenca e personave u raportua në një numër të rasteve dhe në 2 vendvotime personat e paautorizuar udhëhiqnin punën e PSC.

Përderisa në vetëm 3 % të flete votimeve për Kryetar Komune në vend votimet të vizituara u konsideruan të pavlefshme, dhe numri goditës prej 11 për qind u refuzuan zgjedhjet për kuvendin komunal mundësisht duke reflektuar tekniken e re të votimit dhe edukimin e perceptuar të votuesve.

Në 10 raste kryesuesi i vendvotimit nuk ka shpallur rezultate të përkohshme dhe nuk është postuar protokollin me kopjen e rezultateve në hyrje të vendvotimit, siç kërkohet me ligj.

Vëzhguesit lokal ishin prezent në shumicën e vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e ENEMO gjatë numërimit dhe vëzhguesit apo përfaqësuesit e partive qene prezent në të gjitha përpos njërit vendvotim. Në dy raste ankesat janë ngritur dhe shënuar në librin e votimit dhe një ankese formale në KZKA është parashtruar.

## **Ankesat dhe Parashtresat**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) është organ i pavarur dhe i përhershëm, me mandate të shqyrtoj kundërshtimet dhe ankesat lidhur me procesin e zgjedhjeve. KZAP përbehet prej 5 gjykatësve të emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme thekson se anëtarët e emëruar të KZAP do t'i japin prioritet cilëndo çështje lidhur me KZAP duke filluar 60 dite para Ditës së Zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve dhe se të gjitha autoritete të Kosovës do ta ndihmojnë KZAP gjatë kësaj periudhe.

KZAP është një institucion shumë i rëndësishëm mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e integritetit, besueshmëri, transparence të të gjithë procesit zgjedhor. Andaj është për brengje që edhe pse gjykatësit janë emëruar në vitin 2008, autoritete Kosovare nuk kanë qenë në gjendje të lirojnë fondet për funksionimin e duhur të KZAP në kohën në kohën e duhur. Vetëm pas ndërhyrjes dhe mbështetjes nga organizatat ndërkombëtare KZAP ka qenë në gjendje të operacionalizohet në javën e fundit para Ditës së Zgjedhjeve.

Poashtu është brengje se asnjëra nga rastet e veprave penale të prej zgjedhjeve të vitit të cilat KZKA i ka përcjell në gjykatat e përshtatshme nuk është ndjekur.

ENEMO do të vazhdojë të monitoroj punën e KZKA-së përgjatë procesit të kundërshtimeve dhe ankesave në periudhën që vazhdon.

Versioni origjinal i këtij dokumenti është në gjuhën Angleze, dhe ky është përkthimi në Gjuhën Shqipe.